



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr. 971/2 prot

Datë 23.04.2024

**FORMULAR PËR PUBLIKIM
LIDHUR ME ARSYET E SKUALIFIKIMIT TË OPERATORIT EKONOMIK
ANKIMUES DHE PRETENDIMET MBI SKUALIFIKIMIN E OFERTUESVE TË
TJERË**

- Objekt:** Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për skualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik “*Euro Mega 2010*” SHPK në procedurën e prokurimit “*Procedurë e Hapur*”, me Nr. REF-96420-02-26-2024, me objekt “*Blerje detergjent, për Drejtorine e Përgjithshme të Burgjeve*”, me fond limit 39,951,333 (*tridhjetë e nëntë milion e nëntëqind e pesëdhjetë e një mijë e treqind e tridhjetë e tre*) lekë pa TVSH, zhvilluar me datë 20.03.2024 nga autoriteti kontraktor, Agjencia Shtetërore e Prokurimeve të Përqendruara.
- Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për kualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik “*Malvina Visoka*” PF, dhe operatori ekonomik “*AN&RA*” SHPK në procedurën e mësipërme e prokurimit.
- Ankimues:** Operatori ekonomik “*Euro Mega 2010*” SHPK me NIPT K91624505A, me adresa: Fshati Ahmetaq, pranë firmës Ital Kon, Tiranë.
- Autoriteti Kontraktor:** Agjencia Shtetërore e Prokurimeve të Përqendruara.
Adresa: Blv. “Dëshmorët e Kombit”, Nd. 1, 1001, Tiranë
- Subjekte të interesuar:** Operatori ekonomik “*Malvina Visoka*” PF me NIPT L61608005C, me Adresa: Rruga “Muhamet Veliu”, Pallati Iliada, Shk. 1, Kati. 1, Linzë, Tiranë.

Operatori ekonomik “AN&RA” SHPK me NIPT K12205001I me Adresa: Rruga “Barrikadave”, Hyrja. 3, Ap. 10, Ish Kinema 17 Nëntori, Tiranë.

Në datën 22.04.2024 nëpërmjetë sistemit të ankesave elektronike pranë Komisionit të Prokurimit Publik dhe autoritetit kontraktor, është protokolluar ankesa me nr. 971/2024, datë 22.04.2024 dhe numër elektronik A/2024/3998, datë 22.04.2024, e operatorit ekonomik “Euro Mega 2010” SHPK për procedurën e prokurimit “Procedurë e Hapur”, me Nr. REF-96420-02-26-2024, me objekt “Blerje detergjent, për Drejtorine e Përgjithshme të Burgjeve”, me fond limit 39,951,333 (tridhjetë e nëntë milion e nëntëqind e pesëdhjetë e një mijë e treqind e tridhjetë e tre) lekë pa TVSH, zhvilluar me datë 20.03.2024 nga autoriteti kontraktor, Agjencia Shtetërore e Prokurimeve të Përqendruara.

Nga shqyrtimi paraprak i ankesës të sipërcituar, u konstatua se objekti i ankesës lidhet me vendimmarrjen e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi skualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik ankimes “Euro Mega 2010” SHPK si dhe me vendimmarrjen e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi kualifikimin e operatorit ekonomik “Malvina Visoka” PF, dhe operatori ekonomik “AN&RA” SHPK në procedurën e mësipërme e prokurimit.

Bazuar në nenin 112 pika 4 gërmat “b” dhe “c” të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, ku parashikohet se: “Në mënyrë që ankesa të bëhet e aksesueshme jo vetëm nga autoriteti ose enti kontraktor, por njëkohësisht edhe nga operatorët ekonomikë të interesuar, KPP-ja publikon: a) ankesën e plotë në rastin e ankesave për dokumentet e tenderit; b) arsyet e skualifikimit në rastin e ankesave për vendimin e vlerësimit/klasifikimit përfundimtar; c) pretendimet mbi kualifikimin/skualifikimin e ofertuesve të tjerë duke referuar vetëm kriteret për të cilat ngrihen pretendime.”

Komisioni i Prokurimit Publik do të publikojë arsyet e skualifikimit që operatori ekonomik ankimes “Euro Mega” SHPK kundërshton me anë të ankesës si më poshtë vijon:

Arsyet e skualifikimit:

I. Operatori Ekonomik nuk plotëson kërkesën në DST për numrin e ofertave të lejuara në procën e prokurimit nga një ofertues pasi rezulton se ky ofertues paraqiti dy oferta ekonomike. Konkretisht EUROMEGA 2010, ka ngarkuar në SPE dy oferta ekonomike në vlerat: Oferta 1: 33,650,000 (tridhjetë e tre milion e gjashtëqind e pesëdhjetë mijë) lekë pa TVSH (me numra dhe fjalë) Oferta 2.: 27,320,000 (njzetë e shtatë milion milion e treqind e njëzetë mijë) lekë pa TVSH (me numra dhe fjalë).Referuar DST Seksioni i Përgjithshem në këtë procedurë nuk lejohet më shumë se 1 ofertë ose ofertë alternative. Në zbatim të nenit pikës 4 të nenit 79 të VKM nr.285 dt.19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” operatorët ekonomikë duhet të

paraqesin vetëm një ofertë, me përjashtim të rasteve kur kërkohen oferta alternative dhe për këtë arsye subjekti EUROMEGA 2010 s'kualifikohet nga renditja në këtë procedurë dhe ofertat refuzohen.

Gjithashtu, Komisioni i Prokurimit Publik publikon kriteret të cilat operatori ekonomik “Euro Mega 2010” SHPK pretendon se nuk përmbushen nga operatori ekonomik “Malvina Visoka” PF dhe operatori ekonomik “AN&RA” SHPK si më poshtë vijon:

Shtojca 7/2, Krite të Veçanta të Kualifikimit, pika 2.3.5, 2.3.6, 2.3.7 Kapaciteti teknik:

2.3.5. Operatori ekonomik per produktet objekt prokurimi ditën e hapjes se ofertave duhet te paraqes mostrat te cilat duhet të jenë në përputhje me specififikimet teknike në DST, si dhe skeden teknike te prodhuesit në gjuhën shqipe (e përkthyer e noterizuar nëse është në gjuhë huaj).

2.3.6. Operatori ekonomik per secilen nga produktet do te paraqese flete-analize nga nje organ/institucion i akredituar ose i çertifikuar kombetar/nderkombetar të lëshuara brenda 60 (gjashtëdhjetë) ditëve nga hapja e ofertave, duhet të paraqitet origjinale, ose fotokopje të noterizuara.

2.3.7. Operatori ekonomik duhet të deklarojë nëse është prodhues/distributor i autorizuar ose tregtuesi i autorizuar nga prodhuesi/distributori i mallrave për artikujt objekt prokurimi. Në rast kur OE nuk është prodhues i ketyre produkteve/artikujve, ai duhet të disponojë dhe të paraqesë: Autorizim Prodhuesi dhe/ose Kontratë Funizimi/Bashkepunimi nga një Distributor i autorizuar, në të cilat duhet të jenë përcaktuar emertimet e produkteve objekt prokurimi. Autorizimi apo kontrata duhet të përmbaje të dhëna të plota të prodhuesit apo distributorit te autorizuar.

Publikuar në regjistrin e ankesave më datë 23.04.2024

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nënkryetar
Fiorent Zguro

Anëtar
Kreshnik Ternova

Anëtar
Gjergj Mersini